AGJENCIA KOMBËTARE
E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Nr. 2634 Prot.
Datë, më 24.09.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 7068/2 Prot. Tiranë, më 22.09.2026

Lënda: Për njohje dhe zbatim.

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE
Blvd. "Zhan D'Ark", Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rr. "Aleksandër Moisiu", Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rr. "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim udhëzimin nr. 17, datë 18.09.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 9, datë 02.06.2026, "Për përcaktimin e procedurave të njësimit të diplomave të institucioneve arsimore të huaja ose të ngjashme me to, lëshuar nga shkollat private të arsimit të mesëm të lartë, të licencuara në Republikën e Shqipërisë"".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Jona Suli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 7069/1 Prot. Tiranë, më 18.09.2026

UDHËZIM

Nr. 17, datë 18.09 2026

PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 9 DATË 02.06.2026, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË NJËSIMIT TË DIPLOMAVE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË HUAJA OSE TË NGJASHME ME TO, LËSHUAR NGA SHKOLLAT PRIVATE TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË, TË LICENCUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3 të nenit 52 të ligjit nr. 69/2012,"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 9, datë 02.06.2026, "Për përcaktimin e procedurave të njësimit të diplomave të institucioneve arsimore të huaja ose të ngjashme me to, lëshuar nga shkollat private të arsimit të mesëm të lartë, të licencuara në Republikën e Shqipërisë", të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

   a. Në pikën 3 të udhëzimit, pas shkronjës "c", shtohet shkronja "d" me përmbajtje si më poshtë:

   "d) Diploma të lëshuara, në përfundim të programeve të tjera ndërkombëtare, nga shkolla private të arsimit të mesëm të lartë të licencuara në Republikën e Shqipërisë".

   b. Në pikën 6 të udhëzimit, shkronjat "a", "b" dhe "c" ndryshojnë përkatësisht si më poshtë:

   "a) diplomën, në kopje të njësuar me origjinalin nga noteri, të përkthyer nga një përkthyes i licencuar në Republikën e Shqipërisë, së bashku me vërtetimin përkatës të përkthimit;
   b) listën e notave për vitet e arsimit të mesëm të lartë (transkriptin me nota ose dëftesat vjetore), të shkarkuar nga sistemi SMIP dhe të pajisur me vulë elektronike, ose vërtetimin zyrtar të notave për vitet e arsimit të mesëm të lartë, të lëshuar nga institucioni arsimor parauniversitar, të pajisur me fotografinë e nxënësit dhe me vërtetimin e Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare përkatëse;

c) rezultatet e provimeve përfundimtare, kur ato janë zhvilluar, në kopje të njësuar me origjinalin nga noteri dhe të përkthyera nga një përkthyes i licencuar në Republikën e Shqipërisë, së bashku me vërtetimin përkatës të përkthimit.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si edhe shkollat private të arsimit të mesëm të lartë, që zhvillojnë mësimin edhe në gjuhë të huaj, të licencuara në Republikën e Shqipërisë

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

MIRELA KUMBARO FERXHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- MINISTRIA E ARSIMIT